- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Vlerësimit;
 - 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 - 6. Preventivin e çmimeve
 - 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 - 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 - 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
 [Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit /entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bashkelidhur dokumentat ne SPE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: Bashkelidhur ne SPE grafiku i realizimit te punimeve

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.
- 2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse **bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme të ngjashme dhe për këtë duhet të paraqesin :
 - a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
 - b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Vërtetim për realizimin e punimeve (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përkatëse.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, nëse është rasti, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, nëse është rasti, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- N.P – 1 B** Punime gërmimi në tokë;
- N.P - 2 A** Ndërtime civile e industriale;
- N.P – 7 D** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje;
- N.P – 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;

Për punimet special të ndërtimit:

- N.S - 14 B** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;
- N.S - 18 A** Punime topogjeodezike.

2.3.3. Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, çertifikimet.

a) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

- Inxhinieret e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimalisht në 3 muajt e fundit.

Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinieret e sipërpermendur duhet të figurojnë.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

b) Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, jo domosdoshmerisht të përfshirë në liçensën e shoqërisë, minimalisht inxhinieret si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

Për secilin inxhinier duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat inxhinieret e sipërpermendur duhet të figurojnë.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

2.3.4. Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit).

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per kete duhet te paraqitet çertifikata e trajnimit si “Ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave” e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetaret e BOE.*
- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet çertifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, e lëshuar nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesi duhet të figurojë. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anetaret e BOE.*
- 5 (pese) Punonjës specialistë të çertifikuar per punime speciale te saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 Per kete duhet te paraqitet çertifikata e trajnimit e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj, kontrata e punes si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjesit duhet të figurojnë. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet perkatese.*

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve me çertifikatat përkatëse në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik minimumi punonjës si me poshte:

- Teknik Ndërtimi	2 (dy)
- Elektracist	2 (dy)
- Hidraulik	5 (pese)
- Specialist IT	1 (nje)
- Specialist elektroteknik	1 (nje)
- Hidroizolues	1 (nje)
- Karpentier	1 (nje)
- Hekurkthyes	1 (nje)
- Mekanik	1 (nje)
- Saldator	2 (dy)

të vertetuar me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit.

Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operoret ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/çertifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i çertifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					

2				
etj				

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e stafit teknik në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 7 (shtate) manovratore nga të cilët 4 (kater) eskavatoriste, 1 (nje) buldozerist, 2 (dy) automakiniste si edhe 3 (tre) shofere për mjete të tjera.

Per manovratorët të paraqiten deshmite e aftësi profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe ata të figurojnë në listepagesa për të paktën muajin e fundit ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Per shoferët të paraqiten leje drejtimi të vlefshme dhe ata të figurojnë në listepagesa për të paktën muajin e fundit ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e manovratorëve dhe shoferëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 60 (gjashtedhjetë) persona të paktën muajin e fundit.

Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve, për të paktën muajin e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fuqisë punëtore në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

2.3.9. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 Ton	në pronësi ose me qira	1
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12-20 Ton	në pronësi ose me qira	2
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes deri 5-10 Ton	në pronësi ose me qira	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 Ton	në pronësi ose me qira	2
5	Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	në pronësi ose me qira	1
6	Autovinc	në pronësi ose me qira	1
7	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	1
8	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qira	1
9	Eskavator me goma me peshe mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	1
10	Eskavator me zinxhir 0.25 m3	në pronësi ose me qira	2

11	Eskavator me cekic	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
12	Buldozer	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
13	Fadrom me goma me kove para mbrapa	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
14	Minifadrom	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
15	Minieskavator	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
16	Autobot uji	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
17	Rul vibrues gomë-hekur me dhembe (gunga) kapaciteti mbi 16 ton	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
18	Vibrator betoni Thellësie	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
19	Vibrator ngjeshes	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
20	Matrapik	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
21	Betoniere kantieri 500 lit	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
22	Saldatrice	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
23	Gazogjen	<i>në pronësi ose me qira</i>	3
24	Makineri per shpime nentokesore me sistem te kontrollit laser	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
25	Aparat per saldim te harkuar (SMAW), pajisur me certifikate kalibrimi te vlefshme	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
26	Aparat saldimi mig, mag 500A, pajisur me certifikate kalibrimi te vlefshme	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
27	Pajisje matese me ultratinguj spesori, pajisur me certifikate kalibrimi te vlefshme	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
28	Manometer per matjen e presioneve, pajisur me certifikate kalibrimi te vlefshme	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
29	Pajisje X- Ray per inspektimin e saldimit me Radiografi	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
30	Kulle ndricimi me gjenerator	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
31	Balone ndricimi	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
32	Pajisje per hekurkthyes (tranxhe, elektrobango)	<i>në pronësi ose me qira</i>	1
33	Kapese per lidhje hekuri	<i>në pronësi ose me qira</i>	2
34	Total Stacion Robotik (topograf)	<i>në pronësi ose me qira</i>	1

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin dhe fotot përkatëse;
- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plote të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në perfundimin e plote të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fituese.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

2.3.10. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE*
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 3834-2:2006 (Kerkesat e cilësisë për saldimit të materialeve metalike) - ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e perkatëse.*

2.3.11. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licenca/leje lëshuar nga institucionet kompetente si më poshtë:

-Licencë kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.12. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi për materialet dhe pajisjet kryesore që korespondojnë me zërat me nr. rendor në preventiv 12, 27, 43, 44, 46, 48, 49, 50: (Tubat e celikut, Transformator, Mates Smart, Xhunto Cmontimi, Saracineske celiku+Aktuator automatik, Sensor presioni, Data loger, PLC). Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij

2.3.13. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skedë teknike për materialet dhe pajisjet kryesore që korespondojnë me zërat me nr. rendor në preventiv 12, 27, 43, 44, 46, 48, 49, 50: (Tubat e celikut, Transformator, Mates Smart, Xhunto Cmontimi, Saracineske celiku+Aktuator automatik, Sensor presioni, Data loger, PLC), sipas të cilave plotësohen specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. Në katalogun/et/skedat e paraqitura të shihen në mënyrë të dukshme modeli i pajisjes/materialit të ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. (Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat teknike nëq nuk janë në gjuhën shqipe të përktheshme në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)**

<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informacione për nënkontraktorin • Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p>

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

